

VENDIM
Nr. 901, datë 21.12.2016

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT NDËRINSTITUCIONAL PËR IDENTIFIKIMIN E PRONËS SHETETËRORE QË MUND TË KALOJË DHE TË BËHET PJESË E FONDIT TË TOKËS PËR KOMPENSIMIN E PRONAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e fondit për kompensimin e pronave.

2. Komisioni Ndërinstitucional kryesohet nga Zëvendëskryeministri, me përfaqësim nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit. Niveli i përfaqësimit në Komision është të paktën në nivel zëvendësministri.

3. Komisioni Ndërinstitucional ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) I kërkon institucioneve shtetërore vënien në dispozicion të të gjitha informacioneve për pronat, pjesë e listës së inventarit të tyre, si dhe për pronat që janë nxjerrë jashtë funksionit;

b) Identifikon pronat që mund të kalojnë në fondin e tokës;

c) Kërkon nga institucionet shtetërore përkatëse verifikimin e pronave shtetërore që mund të kalojnë në fondin e tokës për kompensim fizik;

ç) I propozon Këshillit të Ministrave kalimin e pronës shtetërore të identifikuar dhe të verifikuar në fondin e tokës.

4. Komisioni Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore mbledhet një herë në muaj, ose në çdo kohë, me kërkesë të kryetarit.

5. Në mbledhjet e Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore, mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera të interesuara, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre është e vlefshme për përmbushjen e detyrimeve të Komisionit.

6. Kryetari i Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore, i raporton Kryeministrit për ecurinë e realizimit të punës së Komisionit të ngritur, problematikat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete të arritura.

7. Komisioni Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore mbështetet nga Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP), në rolin e sekretariatit teknik. ATP-ja ka këto detyra kryesore:

a) Përgatitjen e takimeve të këtij Komisioni;

b) Raportimin periodik në mbledhjet e këtij Komisioni, mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme;

c) Bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për zbatimin e detyrave të këtij Komisioni;

ç) Monitorimin e zbatimit të detyrave të Komisionit;

d) Kryerjen e detyrave që përcaktohen nga kryetari i Komisionit.

8. Të gjitha institucionet e përfshira në këtë proces dhe ato të cilave do t’u kërkohej informacion dhe bashkëpunim nga ana e Komisionit, detyrohen të përgjigjen brenda afateve të kërkuara nga Komisioni. Në rast mosbashkëpunimi, brenda afateve të përcaktuara, i raportohet me shkrim kabinetit të Kryeministrit për marrjen e masave përkatëse, si dhe të masave të referuara në ligjin nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

9. Ngarkohen institucionet e përfaqësuar në Komisionin Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi